

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Shastisja / ed-Deheshu / الدَّهْشُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"فَلَمَّا رَأَيْنَهُ أَكْبَرْنَهُ"

"Me të parë atë, ato mbeten pa mend."<sup>1</sup> (Jusuf, 31)

Shastisja është një tronditje që kap robin me rastin e një incidenti që ia kaplon mendjen, durimin, ose dijen.<sup>2</sup> Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është shastisja e kërkuesit (*murid*) të shtegut të pastrimit shpirtëror atëherë kur:

- Gjendja mund dijen e tij<sup>3</sup>

<sup>1</sup> "Dehesh" është emri foljor i "dehisha" në diatezën veprorë ose "duhisha" në diatezën pësore (vetvetore). Të dyja këto nënkuptojnë shastisje nga tronditja që vjen prej një hasjeje habitëse. Kjo shprehje nuk u përdor në Shpallje. Shejhu (el-Harawi) citoi këtë ajet, për shkak të mahnitjes që përjetuan gratë në këtë ajet, gjë që rezultoi në prerjen e duarve të tyre. Shejhu do që në këtë kapitull të trajtojë ndikimin e fuqishëm të disa gjendjeve shpirtërore, të cilat mund të çojnë në habitje dhe shastisje.

<sup>2</sup> Në *el-Medaarixh*, Ibn el-Kajjim argumenton se, ndërsa kjo gjendje mund të ndodhë në shtegun e devocionit, ndodhja dhe vazhdimësia e saj nuk duhet të kërkohen e as që kjo në vetvete përbën ndonjë virtut që duhet synuar. Zhytja në Siren (jetëshkrimin) e pejgamberit ﷺ dhe të Sahabëve të Tij demonstron bindshëm esullinë e tyre gjatë gjithë kohës dhe vendosjen e tyre në realitet, pa u zhvendosur nga lartësimi që i bënin Zotit ose pa u lëkundur nga kërkimi i kënaqësisë së Tij.

<sup>3</sup> Ndërsa implikimet e dukshme të kësaj mund të jenë problematike, ne supozojmë se shejhu nuk synonte të krijonte një konflikt mes dijes dhe gjendjes shpirtërore; këto dyja duhet të plotësojnë njëra-tjetrën, jo të kundërshtohen mes vete. Ndodh që gjendja shpirtërore të vërë në pah dijen e pasaktë. Mirëpo, Sheriati duhet të gjykojë për të jashtmen dhe të brendshmen e personit dhe të mënjanojë intuitën personale. Sovraniteti i sheriatit përbën dallimin mes ndjekësve të vërtetë të shtegut të pastrimit

- Ekstaza mund tolerancën e tij<sup>4</sup>
- Zbulimi mund Shtysën e tij<sup>5</sup>

Niveli i dytë është shastisja e ndjekësit (*saalik*) të shtegut të pastrimit shpirtëror atëherë kur:

- Bashkimi / shoqërimi (me Allahun) mund identitetin e tij<sup>6</sup>
- Të qenët e Allahut para çdo gjëje mund kohën e tij<sup>7</sup>
- Të parët (e hyjnore) mund shpirtin e tij<sup>8</sup>

Niveli i tretë është shastisja e dashuruesit (*muhib*) atëherë kur:

- Afërsia mund të mirat<sup>9</sup>
- Drita e afërsisë mund dritën e mirësisë<sup>10</sup>
- Malli për të parë mund mallin që ngjallet nga të dëgjuarit (e transmetimeve)<sup>11</sup>

---

shpirtëror dhe të devijuarve. Nëse gjendja shpirtërore kaplon dijen e personit në mënyrë që ai, për shembull, parapëlqen adhurimin në vetmi ndaj namazit me xhemat, më së shumti që mund të thuhet për të këtillin është se mund të arsyetohet, ndonëse Shpallja është përcaktuesi përfundimtar i vlerave të veprave.

<sup>4</sup> Ai mund të klithë ose të shfaqë lëvizje të rrëmbyeshme, nëse nuk arrin të ruajë qetësinë.

<sup>5</sup> Sepse Zbulimi sjell afër atë që ka qenë duke u kërkuar nga Shtysa.

<sup>6</sup> Bashkimi / shoqërimi i tij me Allahun do ta bëjë të mos ndiejë praninë e vet.

<sup>7</sup> Fakti që i Pari pa fillim i ka paraprirë çdo gjëje do të bëjë që koha e tij të venitet.

<sup>8</sup> Shpirti mund të mos durojë të parët e të Dashurit.

<sup>9</sup> Afërsia ndaj Allahut errëson të mirat që Ai jep.

<sup>10</sup> Ngjashëm me konceptin paraprak.

<sup>11</sup> Malli që u shkaktua nga transmetimet (e Shpalljes) tash tejkalohet nga malli i shkaktuar nga përjetimet shpirtërore personale të hyjnore.